



European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction

TD-31-11-375-64-C

KOSOVA
(sipas Rezolutës 1244 të KS të KB)

PASQYRA E VENDIT 2010

KOSOVO (prema RSBUN 1244/99)

PREGLED ZA ZEMLJU 2010



European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction

KOSOVA
(sipas Rezolutës 1244 të KS të KB)

PASQYRA E VENDIT 2010

KOSOVO (prema RSBUN 1244/99)

PREGLED ZA ZEMLJU 2010

Legal notice

This publication of the European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA) is protected by copyright. The EMCDDA accepts no responsibility or liability for any consequences arising from the use of the data contained in this document. The contents of this publication do not necessarily reflect the official opinions of the EMCDDA's partners, the EU Member States or any institution or agency of the European Union or European Communities.

A great deal of additional information on the European Union is available on the Internet. It can be accessed through the Europa server (<http://europa.eu>).

Europe Direct is a service to help you find answers to your questions about the European Union.

Freephone number (*):
00 800 6 7 8 9 10 11

(*) Certain mobile telephone operators do not allow access to 00 800 numbers or these calls may be billed.

This publication is available in English, Albanian and Serbian.

Cataloguing data can be found at the end of this publication.

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011

ISBN 978-92-9168-493-9

doi: 10.2810/49836

© European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction, 2011
Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

Printed in Spain

PRINTED ON WHITE CHLORINE-FREE PAPER



European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction

Cais do Sodré, 1249-289 Lisbon, Portugal
Tel. (351) 211 21 02 00 • Fax (351) 218 13 17 11
info@emcdda.europa.eu • www.emcdda.europa.eu

KOSOVA (sipas Rezolutës 1244 të KS të KB) (SQ)	7
KOSOVO (prema RSBUN 1244/99) (SR)	21

Light blue bar

Dark blue bar

Light blue bar

Dark blue bar

Light blue bar

Dark blue bar

Përmbajtja (SQ)

Hyrje	9
Pasqyra demografike e shoqërisë	10
Përdorimi i drogës tek popullsia e përgjithshme dhe të rinjtë	11
Preventiva	11
Problematika e përdorimit të drogës	12
Kërkesat për trajtim	12
Sëmundjet infektive të ndërlidhura me drogat	13
Vdekjet e shkaktuara nga drogat	14
Rezultatet e trajtimit	14
Rezultatet nga zvogëlimi i dëmit	15
Tregu i drogës dhe krimet e lidhura me drogën	15
Ligjet kombëtare të drogës	17
Strategjia kombëtare mbi drogën	17
Mekanizmi bashkërendues në fushën e drogave	18
Referencat	18



Hyrje

Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varshmërinë nga Drogat (EMCDDA) së bashku me Komisionin Evropian, Shtetet nëtare dhe Europol-i është caktuar si institucioni kryesor për të implementuar Objektivin 19 – Aksioni 60 të Planit Veprues të BE-së (2009–12), që parashihet asistencën teknike për shtetet kandidate në procesin e stabilizim-asociimit. Ky objektivi fton për ofrimin e asistencës së nevojshme teknike dhe tjera për shtetet kandidate për procesin e asociimit-stabilizimit që të familjarizohen me standardet e BE-së (*acquis*) në fushën e drogave si dhe të asistojnë në implementimin e veprimëve të nevojshme. Rregulla e re e EMCDDA e adaptuar me 12 dhjetor 2006 nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian gjithashtu në mënyrë të qartë identifikon vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) si partnere kryesore të EMCDDA-së.

Procesi i asociim-stabilizimit është pjesë e agjendës për negociatat e BE-së me vendet e BP deri në pranimin e tyre eventual. Procesi ndihmon vendet aspirantë që të rrisin kapacitetet e tyre që të adaptojnë dhe zbatojnë ligjet e BE-së si dhe standardet evropiane dhe ato ndërkombëtare.

Në 2010, EMCDDA inicioj projektin e bashkëpunimit dhe asistencës teknike me vendet e BP siç janë: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova (nën rezolutën 1244/99 të KS të KB), Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, financuar nga Fondi i Komisionit Evropian i Instrumentit Para-pranimit (IPA). Qëllimi kryesor i projektit është që edhe më shumë të fuqizoj kapacitetet e vendeve të BP dhe Turqisë që në nivel kombëtar të vendosin një sistem të informimit mbi drogat që do të jetë në përputhje me standardet e EMCDDA.

Qëllimet e projektit për Kosovën (sipas Rezolutës 1244 të KS të KB) janë si më poshtë:

- Përgatitja e një vlerësimi të detajuar të të dhënave dhe të resurseve në dispozicion (hartë informative), e cila do të mbulonte gjendjen e 'e pesë indikatorëve kryesor' (5 IK-të) si dhe të dhënat bazike. Gjithashtu, vlerësimi përfshinë edhe legjislacionin dhe përgjegjësitë të shoqëruara me rekomandime konkrete për projektet kombëtare që mbulojnë programet për përpilimin e Pasqyrës së Situatës në Vend (CSS) si dhe për implementimin e aktiviteteve specifike për mbledhjen e të dhënave;
- Publikimi i parë i pasqyrës (raportit) CSS për Kosovën (sipas Rezolutës 1244 të KS të KB);
- vlerësimi i potencialit për krijimin e zyres kryesore kombëtare në vend në lidhje me mundësinë për participimin në punën e EMCDDA-së;

Projekti i parë evropian studimor shkollor për alkoolin dhe drogat tjera (ESPAD), hulumtim ndër nxënësit e moshës 15–16 vjeçare.

Grupi punues

Ilir Begolli, MD, MSc, PhD, Professor Ass., Drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë.

Shaban Mecinaj, MD, Ass. Në Psikiatri, Qendra Klinike Universitare në Kosovë, Klinika psikiatrike, Shef i repartit për trajtimin e varshmërisë

Pashk Buzhala, MD, Epidemiolog, Shef i Departamentit të Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë

Bahri Shala, Drejtorati për hetimet e trafikimit me narkotikë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Punëve të Brendshme

Safet Blakaj, Qendra Medicinale Psiko-terapeutike "Labyrinth", Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së "Labyrinth".

Pasqyra demografike e shoqërisë

Të dhënat kryesore				
	Viti	Kosova (sipas Rezolutës 1244 të KS të KB)	BE (27 vendet)	Burimi
Sipërfaqja	2011	10 887 sq km	4 200 000 km ² (viti 2008)	Eurostat
Popullsia	2011	1 825 632	501 105 661 (të përkohshme për 2010)	(Korrik 2011 parashikim). Për BE — Eurostat
Prodhimi Bruto vendor — për kokë banori	2010	USD 6 600	USD 32 615 (nominal)	(2010 parashikim) — Ëkipedia.org 2010
Pa-barazia e shpërndarjes së të hyrave	2008	N/A	100	Eurostat
Përqindja e papunësisë (!)	2009	45 %	9.6 %	2009 parashikim — të dhënat nga 2010 Eurostat
Të burgosurit	2005	63		Lista e të burgosurve botëror (edicioni i shtatë)

Burimi: World Factbook: *<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html> (faqja është ri-freskuar për herë të fundit me 6 korrik 2010)

(!) Trendi i papunësisë paraqet personat e papunë si përqindje me fuqinë punëtore. Personat e papunë përfshijnë personat e moshës nga 15 deri 74 vjet: (a) të papunë gjatë javës referente, (b) momentalisht të gatshëm për punë, (c) kërkojnë punë në mënyrë aktive.

Kosova (sipas Rezolutës së KS të KB 1244/99) shtrihet në Evropën jug-lindore me një sipërfaqe prej 10 887 kilometra katrorë. Ajo është e rrethuar nga Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia. Sipas informacionit të dhënë në *World Factbook* për vitin 2010 thuhet se Kosova ka rreth 1 804 838 banorë. Prishtina është kryeqyteti me rreth 500 000 banorë. Shumica e popullsisë është shqiptare (88%), shumica janë myslimanë dhe flasin shqip. Një tjetër grup i madh etnik është ai serb (7%), të cilët kryesisht janë të krishterë ortodoks dhe flasin serbisht. Pjesa e mbetur prej 5% e popullsisë është e përbërë nga turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptas, etj.

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur. Pavarësia e Kosovës u njoh zyrtarisht nga 75 shtete nga gjithsej 192 shtete anëtare të OKB-së. Këto vende përfshijnë 22 nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian (e fundit në shkurt 2011). Kushtetuta e re e Kosovës e miratuar nga Kuvendi hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kosova qeveriset nga institucionet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore që rrjedhin dhe janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konfirmoi faktin se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare (!).

Qytetet më të mëdha përveç Prishtinës janë Prizreni, Peja, Mitrovica, Ferizaji, Gjakova dhe Gjilani.

(!) Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë: <http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&code=kos&case=141&k=21>

Përdorimi i drogës tek popullsia e përgjithshme dhe të rinjtë

Edhe pse janë shumë subjekte që kanë informacione mbi drogat, nuk ekziston një studim i mirëfilltë gjithëpërfshirës që do të tregonte dimensionin e vërtet të problemit të drogave.

Në nivelin kombëtar mungojnë studimet dhe hulumtimet mbi përdorimin e drogave tek popullsia e përgjithshme. Në vitin 2008, një numër i studimeve janë zhvilluar secili prej tyre duke shfrytëzuar metoda të ndryshme, mostra të ndryshme dhe grup-mosha të ndryshme (kryesisht të rinjtë dhe njerëzit pa mbrojtje dhe ose që janë në rrezik).

Në vitin 2008, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) dhe Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNPFA) zyret në Kosovë, u zbatua studimi i vlerësimit dhe reagimit të shpejtë (RAR) tek të rinjtë, përdoruesit intravenozë të drogave dhe tek të burgosurit (Brisonn, Arenliu dhe Platais, 2009). Madhësia e mostrës ishte e përbërë prej 1 302 personave të anketuar të moshës 15-24 vjeçare. Përdorimi i përhershëm i kanabisit dominonte tek të rinjtë (5.5 %) pastaj tek femrat e reja (2.2 %) dhe tek ata të moshës nga 20 deri 24 vjet si dhe tek ata që janë më të rinj se 18 vjeçar (1.7 %). Shumica e të rinjve deklaruan se kanë filluar të konsumojnë kanabis në moshën 17 vjeçare, pa ndonjë dallim në baza gjinore. Përdorimi i ekstazisë u raportua nga 0.6% e të rinjve të intervistuar gjersa përdorimi i heroinës dhe amfetaminës (apo ndonjë lloji tjetër të dopingut) nga 0.4 % e mostrës. Përafërsisht, 0.2 % e të rinjve të intervistuar kanë pranuar se kanë provuar kokainën. Përafërsisht 2.6 % e të intervistuarve raportuan përdorimin e drogave farmaceutike siç janë Trodon, Tramal, Bensedin, Fortral, Valeron dhe Methadone/Heptanon, të siguruar në mënyrë ilegale. Të rinjtë pranuan se filluan marrjen e këtyre medikamenteve në moshën 13–20 vjeçare duke e bërë kështu moshën 17 vjeçare si moshën mesatare të fillimit të përdorimit.

Deri në vitin 2010, në Kosovë, nuk është zhvilluar as një Hulumtim Projekt Evropian Shkollor mbi Alkoolin dhe Drogat tjera (ESPAD). Megjithatë Kosova merr pjesë në mbledhjen e të dhënave ESPAD mbi trendet dominante të përdorimit të drogave tek nxënësit e moshës 15–16 vjeçare.

Preventiva

Strategjia Kombëtare Kundër Drogës e Kosovës dhe Plani i Aksionit i miratuar në vitin 2009 si prioritet ka masat preventive kundër drogës si pjesë e aktiviteteve të reduktimit të

kërkesës për drogë. Strategjia promovon kujdesin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës, parandalimin e përdorimit të drogave dhe eksperimentimit me drogat; intervenimet e hershme për të reduktuar pasojat shëndetësore dhe sociale që lidhen me përdorimin e drogave; dhe qasje në shërim, rehabilitim shoqëror dhe ri-integrim. Strategjia parasheh intervenimet preventive që synojnë grupet specifike, institucionet shkollore dhe ato para-shkollore, familjet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Institucioni i vetëm kompetent për të zhvilluar dhe promovuar edukimin shëndetësor mbi parandalimin e përdorimit të drogave dhe pasojat e saja sipas nenit 32, paragrafi 32.3 i Ligjit të Kosovës mbi Substancat Narkotike, Psykotropike dhe Pararendëset (ligji Nr. 02/L-128), është Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës.

Preventiva universale

Deri tani shumica e aktiviteteve të preventivës universale kanë qenë të bazuara në intervenime spontane të subjekteve apo individuale në bashkëpunim me shkollat dhe së fundmi me OJQ-të dhe Policinë e Kosovës. Në shkolla, klasat janë mbajtur siç janë parashikuar në kurikulum. Gjithashtu OJQ-ve qofshin ato lokale apo ndërkombëtare i`u është dhënë hapësirë që t`i zhvillojnë aktivitetet e tyre të planifikuara në projekte që kryesisht kanë qenë të financuara nga donatorë të huaj. Në këtë mënyrë, Grupi i Edukimit Shëndetësor zhvilloj një seri të aktiviteteve edukative shëndetësore mbi drogat në shkollat-shtëpi para vitit 1999 me përkrahjen e Fondacionit SOROS. Gjatë 2003, organizata 'Mjekët Pa Kufij' në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës zbatoj (implementoj) një program në gjithë territorin e Kosovës i cili kryesisht ishte i bazuar në teknikën e njohur si 'peer-to-peer'. UNICEF gjithashtu ka paraparë një modul mbi drogat në projektin e përbashkët me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të quajtur 'Njohuritë për jetën'.

OJQ-ja lokale 'Labyrinth', një OJQ që kryesisht merret me trajtimin-shërimin nga drogat dhe zvogëlimin e pasojave, në bashkëpunim me OJQ-të tjera të të rinjve luan një rol aktiv preventiv në komunitet si dhe në shkolla, si pjesë e aktiviteteve jashtë-kurikulumit.

Preventiva selektive

Sistemi korrektues përbrenda burgjeve gjithashtu aplikon aktivitete preventive që kanë si qëllim edukimin shëndetësor dhe promovimin e informimit mbi drogat, sëmundjet ngjitëse që ndërlidhen me drogat si dhe sëmundjet seksualisht të transmetuara dhe HIV/AIDS.

Problematika e përdorimit të drogës

Deri në vitin 2010 nuk ekziston një parashikim mbi numrin e përdoruesve të drogave në Kosovë. Sipas mendimit të ekspertëve kombëtar, numri i përdoruesve të heroinës mendohet të jetë diku nga 3.000 deri në 5.000 persona (2010, Bahri Shala nga Njësia Anti-Drogë e Policisë së Kosovës dhe dr. Shaban Mecinaj — Klinika Psikiatrike ÇKUK). Mungesa e të dhënave të besueshme vjen si rezultat i vështirësive që paraqiten në koordinimin dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet të gjithë akterëve përkatës të involvuar si dhe si pasojë e mungesës së eksperiencës për të bërë parashikime mbi problematikën e përdoruesve të drogës.

Shifra që më së shumti citohet është ajo se në Kosovë janë 10 000–15 000 përdorues të drogës prej cilëve përafërsisht 4 000–5 000 janë përdorues të heroinës. Disa publikime (departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 2009) dhe raporte i referohen shifrës prej 3 000-deri 5 000 si përdorues intravenozë të drogës. Megjithatë, gjatë misionit fakt-mbledhës të EMCDDA, ka qenë a pamundur të vërtetohet kjo shifër sepse nuk ka pasur një metodologji të sigurt dhe specifike me të cilën është arritur tek shifra e parashikuar (EMCDDA, 2010).

Studimi i Vlerësimit të Shpejtë dhe Përgjigjet në 2008 (Brisson, Arenliu dhe Platais, 2009) tregoi se nga përdoruesit intravenozë të drogës (IDUs) të grupmohës nga 19 deri 49 vjeçar, 85 % ishin meshkuj gjersa 15 % ishin femra. Përqindja e të anketuarve që kanë konsumuar drogë gjatë tre muajve të fundit ishte 98 % gjersa 85 % treguan se kanë injektuar një lloj droge gjatë tre muajve të fundit. Nga ata që kanë raportuar injektimin, mosha e injektimit për herë të parë ishte 14 vjet. Mesatarisht të intervistuarit IDU (përdorues intravenozë të drogave) kanë filluar të injektohen më së paku një herë në javë në moshën 21 vjeçare (grupmosha ishte 15–38 vjet).

Më pak se gjysma e tyre (47 %) e IDU-ve (përdoruesve intravenozë) kanë qenë në ndonjë trajtim të drogës ose në një program të detoksifikimit. Nga ky grup, 94 % janë trajtuar në Prishtinë. Nga të gjitha trajtimet, në më së shumti raste, trajtimet kanë qenë: detoksifikim me metadon (18 %), detoksifikim me drogat tjera (21 %) dhe rehabilitim rezidencial (34 %).

Kërkesat për trajtim

Nuk ekziston një sistem i mbledhjes së të dhënave që mbulojnë trajtimin për drogë në gjithë vendin.

Trajtimi i drogës në Kosovë momentalisht ofrohet nga dy subjekte kryesore: Qendra Klinike Universitare — klinika psikiatrike dhe OJQ 'Labyrinth'. Ato më së shumti ofrojnë shërbime të ditoksifikimit (pastrimit), trajtim psiko-social dhe trajtim duke përdorur medikamente të ndryshme.

Duke u bazuar në informatat e siguruar nëpërmjet intervistave me informantë kyç, në kliniken psikiatrike në Prishtinë, çdo vit trajtohen rreth 80 pacientë gjersa OJQ-ja 'Labyrinth', që nga fillimi i punës, ka ofruar trajtime ambulatorie siç janë konsultat për më shumë se 700 përdorues të drogës (EMCDDA, 2010).

Klinika psikiatrike

Klinika psikiatrike e Qendrës Universitare Klinike të Kosovës është një shërbim publik për gjithë vendin dhe ofron programe të ditoksifikimit. Megjithatë, nuk ofron trajtime në rast të mbi dozimit të cilat menaxhohen nga Qendrat Emergjente të institucioneve tjera shëndetësore. Kjo klinikë ofron trajtim ambulator dhe spitalor dhe paraqet burimin kryesor të informatave mbi kërkesat për trajtim.

Të dhënat e siguruar nga Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës që nga viti 2005 tregojnë një ngritje të kërkesë për trajtim; nga 147 e kërkesave për trajtim ambulator dhe spitalor në vitin 2006, 165 (2007), 172 (2008) dhe 198 kërkesa për trajtim në vitin 2009.

Në vitin 2010 në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ishin 186 raste të kërkesave prej së cilave 36 pacientë morën trajtim për herë të parë në jetën e tyre (shiko tabelën 1).

Tabela 1: Numri i vizitave dhe i klientëve në 2009 dhe 2010

	2009	2010
Numri i vizitave	783	639
Numri i klientëve ambulator	135	114
Numri i klientëve spitalor	63	72
Numri mesatar i vizitave për klient për vit	3.7	3.4

Burimi: Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, 2010

Shumica absolute (më shumë se 95 %) e klientëve në 2009 dhe 2010 në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ishin meshkuj (shiko tabelën 2).

Tabela 2: Shpërndarja gjinore e klientëve që morën trajtim ambulator dhe spitalor në 2009 dhe 2010

	2009	2010
Meshkuj	95.4	96.2
Femra	4.6	3.8

Burimi: Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, 2010

Mosha mesatare e pacientëve në 2010 ishte 30 vjet (29.5 vjet në 2009); shumica e klientëve (39.7 %) i takonin grupmoshës 31–40 vjeçare ndjekur nga grupmosha 21–30 vjeçare.

Në vitin 2010, afërsisht një e treta e të gjithë klientëve të trajtuar (35.9 %) kishin arsimim në nivelin fillor apo nën të, ndjekur nga 34.4 % e atyre me arsim të mesëm dhe 13.9% me arsim të mesëm të papërfunduar, ndërkohë që 7 % ishin me arsim profesional. Rreth 15% kishin të filluar arsimin e lartë, por vetëm 4.3 % e kishin mbaruar atë. Shifra të ngjashme janë vërejtur edhe në mesin e atyre që hynë në trajtim në vitin 2009.

Vetëm një pakicë e klientëve të trajtuar (4 %) kishte një punë të përhershme, rreth një e treta (35.4 %) ishin të punësuar të përkohshëm, ndërsa shumica (44.9 %) nuk kanë qenë të punësuar gjatë gjithë vitit të fundit para hyrjes në trajtim. Rreth 12 % e klientëve ishin nën moshën 18 vjeçare.

Rreth gjysma e klientëve (48.9 %) ishin banorë të regjionit të Prishtinës, ndjekur nga 27.9 % nga regjioni i Prizrenit, 19.8% nga regjioni i Gjiçanit, 9.1 % nga regjioni i Mitrovicës, 8 % nga regjioni i Pejës, ndërsa disa pacientë jetonin jashtë Kosovës.

Në vitin 2009, shumica e klientëve raportuan se kanë përdorur opiate (kryesisht heroinë) (82 %), pasuar nga kokaina dhe stimulantë tjerë (3 %), kanabis (8 %), dhe alkool (7 %). Ndër të gjitha rastet e kërkesës për trajtim, rreth një e treta (33.7 %) e pacientëve raportuan përdorimin e polydrogave (disa lloje të drogave), dhe 17.5 % e pacientëve kishte një çrregullim të ndërlidhur mendor.

Sa i përket asaj se në ç`mënyrë janë marr drogat, 38.4 % e klientëve raportuan se kanë konsumuar drogën duke e injektuar atë, gjersa 43.7 % raportuan se drogën e kanë marr me anë të pirjes me duhan, me anë të hundës apo duke e inhaluar. Për 17.9 % të klientëve mungonte informacioni mbi mënyrën e marrjes së drogës.

Labyrinth

OJQ Labyrinth që gjendet në Prishtinë, ofron trajtime ambulatorie psiko-sociale për drogat. Në 2010, kishte 5 625 kërkesa për trajtime nga të cilat 142 kërkesa për trajtim për herë të parë, që është më shumë në krahasim me 2009 (112 klientë u trajtuan për herë të parë).

Sikurse tek shifrat e raportuara mbi shpërndarjen gjinore edhe tek klientët që kërkonin trajtim për herë të parë në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, shumica absolute (më shumë se 90 %) e klientëve të OJQ-së Labyrinth ishin meshkuj (shiko tabelën 3).

Tabela 3: Shpërndarja gjinore e trajtime ambulatorie për pacientët e trajtuar për herë të parë në 2009 dhe 2010.

	2009	2010
Meshkuj	91.1	93.0
Femra	8.9	7.0

Burimi: OJQ Labyrinth, 2010.

Mosha mesatare e klientëve që janë trajtuar për herë të parë në OJQ-në Labyrinth ishte disi më e ulët, 28.7, krahasuar me ata të trajtuar në Klinikën Psikiatrike, që është 30 vjeç.

Në 2010, më shumë se 2/3 (69.1 % në 2010 dhe 74.1 % në 2009) të klientëve që kanë kërkuar trajtim për herë të parë kanë qenë të papunësuar.

Rreth gjysma (58.4 %) e klientëve që kanë kërkuar trajtim për herë të parë, kanë jetuar jashtë e Kosovës së paku një herë. Rreth 2/3 (68.3 %) e klientëve të trajtuar për herë të parë raportojnë se kanë filluar me përdorimin e drogës gjersa jetonin në Kosovë, ku mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogës ishte 18.2 vjeç.

Fare më pak se gjysma (44.4 %) e klientëve të trajtuar për drogë për herë të parë kanë qenë më së paku një herë të burgosur gjatë jetës së tyre.

Gjatë studimit, shumica e përdoruesve të trajtuar (87.3 % në 2010 dhe 84.8 % në 2009) treguan se jetojnë me familjet e tyre.

Substanca më së shpeshti e përdorur tek klientët e trajtuar për herë të parë ishte heroina (89.4 %); mosha mesatare e fillimit të përdorimit të heroinës ishte 21.5 vjeç; doza mesatare ditore e heroinës ishte rreth 2.4 gram.

Rreth 1/3 –ta (35.9 %) e klientëve të trajtuar për herë të parë në OJQ Labyrinth raportuan përdorimin e drogës me injektim gjersa 23.4 % raportuan se kanë pasur mbi-dozim në të kaluarën. 6.3 % raportuan se kanë pasur probleme shëndetësore apo kanë pësuar sëmundje ngjitëse.

Sëmundjet infektive të ndërlidhura me drogat

Informatat për sëmundjet infektive të lidhura me drogat në Kosovë vijnë nga projektet e testimit dhe këshillimit për HIV/AIDS, nga Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik i Kosovës, Departamenti i epidemiologjisë dhe Departamenti i Mikrobiologjisë që përfshinë edhe laboratorët përkatës për HIV, Hepatitin Viral dhe Infektimet e Transmetuara përmes Seksit – ITS.

Në 2006 Shëndeti Familjar Ndërkombëtar implementoi një studim për mbikëqyrjen e bio-sjelljes (sjelljes biologjike) (BioBSS). Qëllimi i këtij studimi ishte që të ngritet një kapacitet kombëtar për mbikëqyrjen e HIV dhe mbledhja e të dhënave të sjelljes të grupeve me rrezikshmëri të lartë si dhe për të vlerësuar përhapjen e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (ITS) dhe HIV-it (Shëndeti Familjar Ndërkombëtar, 2006).

Në këtë studim është përdorur mostrifikimi sipas respondentëve ('RDS') për të rekrutuar 200 përdorues intravenoz dhe 69 mashkuj që kishin pasur marrëdhënie seksuale me mashkuj tjerë ('MSM'), ndërsa mostrifikimi sipas rastit është bërë për të rekrutuar 157 punëtorë të seksit komercial ('CSW'). Softveri RDS është përdorur për të ardhur deri te parashikimi brenda popullatës dhe *intervallet e sigurta* ('Confidence Intervals') për të përshkruar rrejtin e zgjeruar të përdoruesve intravenoz dhe mashkujve që bëjnë seks me mashkuj ('MSM'). Secili pjesëmarrës plotësoi një pyetësor i cili pasohet me teste (Shëndeti Familjar Ndërkombëtar, 2006).

Rezultatet tregojnë se asnjëri nga të rekrutuarit IDU (përdorues intravenozë) nuk ishte HIV pozitiv e as sifiliz, gjersa rreth 35 e IDU-ve të testuar ishin të infektuar me Klamidia dhe rreth 20 % konsiderohen të kenë Hepatitin B dhe 13 % Hepatitin C.

Studimi i dytë BioBSS me të njëjtën metodologji sikurse ai në vitin 2006 pritet të implementohet në 2011 në kuadër të projektit të financuar nga Fondi Global për të luftuar AIDS, Tuberkulozen dhe Malarien (GFATM). Ky studim do të shqyrtojë më tej situatën në lidhje me përhapjen e sëmundjeve ngjithëse në mesin e grupeve me rrezik të lartë, duke përfshirë përdoruesit intravenoz (IDU-të).

Në 2010, OJQ-ja 'Labyrinth' zhvilloi 195 sesione vullnetare të testimi dhe këshillimit (këshillime para dhe pas testimi) me IDU-të. Nga klientët e testuar rreth 24 % ishin të infektuar me HCV dhe 13 % me HBV. Asnjëri nga klientët e testuar nuk ishte HIV pozitiv, 10 % rezultuan pozitivë për HBV (60 raste) dhe 23 % për HCV (154 raste).

Informacionet nga baza e të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik tregojnë se ka dy përdorues intravenoz të cilët janë të infektuar me HIV: një rast, u regjistrua në 2004, ndërsa një tjetër, në vitin 2009. Numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara me HIV në Kosovë, që nga rasti i parë i regjistruar në vitin 1986 e deri në fund të muajit qershor 2011 ishte 81. Rruga kryesore e transmetimit është heteroseksuale. Përqindja më e madhe e infektuar janë meshkuj të rritur, ndërsa në vitin 2009 është raportuar për infeksione në mesin e fëmijëve. Në fillim të epidemisë së HIV-të shumica e rasteve pozitive është regjistruar tek kosovarët që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës.

Vdekjet e shkaktuara nga droga

Nuk ekziston një e dhënë e saktë mbi numrin e të vdekurve nga droga në Kosovë. Të dhënat zyrtare mbi vdekjet e shkaktuara nga droga janë relativisht të dobta, faktikisht inekzistente, dhe atë për shkak të disa arsyeve:

- ekziston një mungesë e vetëdijes së përgjithshme në mesin e profesionistëve të shëndetit në lidhje me vdekjet e shkaktuara nga droga dhe si rezultat, numri i vdekjeve të shkaktuara nga mbi-dozimi me drogë në mënyrë sistematike kualifikohen si arreste/sulme kardiake;
- nuk ka bashkëpunim dhe koordinim në mes të agjencive respektive dhe nuk bëhet shkëmbimi i informacioneve në lidhje me vdekjet e shkaktuara nga droga;
- edhe pse Laboratori Toksikologjik i Institutit për Medicinë Ligjore është në gjendje që të konfirmoj vdekjet e shkaktuara nga drogat, ekziston një mungesë e informatave dhe mungesë e vetëdijes mbi ekzistencën e kësaj lloji agjencie të kualifikuar;
- për më shumë, autoritetet rrallë bëjnë analizat e lëngjeve të trupit në raste të vdekjeve toksikologjike, sepse ka ende një stigmatizim kur është fjala për fenomenin e varësisë dhe kjo, nga ana tjetër, bën të pamundur për Institutin e Mjekësisë Ligjore të bëjë një autopsi të viktimës përveç nëse një gjë e tillë është e autorizuar dhe e kërkuar (nga familja e viktimës).

OJQ-ja 'Labyrinth' posedon një regjistër dhe mban të dhënat e të gjitha rasteve të vdekjes në mesin e klientëve të regjistruar. Informacionet mbi vdekjet e mundshme janë raportuar nga klientët dhe janë vërtetuar nga familja përkatëse dhe policia. Sipas informatave në dispozicion në këtë qendër, dy përdorues të drogës kishin vdekur në vitin 2004, ndërsa tre në vitin 2006, një në 2007, nga pesë në 2008 dhe 2009 dhe 15 në vitin 2010. Supozohet që të gjitha këto raste të vdekjes ishin nxitur ose shkaktuar nga droga.

Rezultatet e trajtimit

Mundësitë për trajtim në Kosovë janë të limituara, me vetëm programin e ditoksifikimit që ofrohet momentalisht. Ministria e Shëndetit ende nuk ka ndarë fonde të dedikuara për të mbuluar trajtimin me substanca opioide me metadon dhe buprenorfinë prandaj ky trajtim ende nuk është në dispozicion. Megjithatë programi i parë me metadon do të startoj me 2011 si pjesë e projektit të financuar nga GFATM. Trajtimi i ditoksifikimit përfshin barëra bazike që janë në listën esenciale të financuar nga Ministria e Shëndetësisë. Intervenimet psiko-sociale janë të rralla.

Ofruesit e shëndetësisë primare si dhe shërbimet publike sociale nuk janë të përfshira në trajtimin e përdoruesve problematik të drogës. Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së trajnimeve të duhura dhe mungesës së të kuptuarit të rolit të tyre në fushën e trajtimit të drogës.

Deri në vitin 2004, trajtimi i drogës është kryer në repartet e ndryshme të klinikës psikiatrike. Megjithatë, nga fundi i vitit 2004, klinika ka filluar të ofrojë shërbime të veçanta ambulatorore dhe spitalore të trajtimit të drogës. Në vitin 2008, Klinika psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka krijuar një repart të veçantë (dy dhoma me gjashtë shtretër) për të trajtuar varësinë. Klinika ka një protokoll për trajtimin e klientëve të stacionar. Deri më tani trajtimi ka qenë i bazuar vetëm në programet e ditoksimin.

Trajtimet ambulatorore psiko-sociale të drogës janë dhënë nga OJQ Labyrinth me bazë në Prishtinë, e cila ka njësi për kryerjen e veprimtarive në Prizren, Gjiilan dhe Prishtinë.

Në ndërkohë, strategjia kombëtare kundër drogës e miratuar në 2009, është hartuar për të krijuar dhe forcuar kapacitetet e trajtimit, nëpërmjet krijimit të Institutit për varësinë e drogës, institucion pranë Qendrës Klinike të Kosovës me dy njësi për pacientët e jashtëm dhe pacientëve të shtruar, në të cilat kryesisht do të realizoheshin programet e ditoksimin dhe mirëmbajtjes. Ky institut do të menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Pengesat dhe problemet që penguan zbatimin e trajtimit të mirëmbajtjes me Metadon (MMT) janë tejkaluar dhe pritet që në vitin 2011 ky trajtim të fillojë në Kosovë. Pritet që MMT do të ofrohet në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe numri i klientëve që pritet për dy vitet e para është vlerësuar të jetë 90 persona. Zbatimi i MMT është mbështetur nga projekti i financuar nga GFATM.

Rezultatet nga zvogëlimi i dëmit

Programet për zvogëlimin e dëmit kanë filluar të implementohen në 2005 dhe fillimisht janë ofruar nga OJQ-ja "Labyrinth" në Prishtinë. Megjithatë tani këto programe implementohen edhe në Prizren dhe Gjiilan me përkrahjen e GFATM.

Aktivitetet në zvogëlimin e dëmit përfshijnë testime dhe konsulta vullnetare, shpërndarja e prezervativëve dhe shpërndarja e materialit informativ gjersa nga 2009-ta në një vend të caktuar ka filluar të shpërndahen edhe gjilpëra dhe shiringa.

Në periudhën 2005–08, 610 përdorues të drogës kanë marr pjesë në programet e testimit dhe konsultimit vullnetar të

realizuara nga OJQ 'Labyrinth'. Shumica e tyre ishin meshkuj (86%), rreth 15% të IDU-ve ishin më të rinj se 19 vjeçar, gjysma ishin të moshës 20–24 vjeç dhe 35% më të vjetër se 24 vjet. Shumica e personave të testuar ishin nga Prishtina (61%) gjersa 36% nga qytetet tjera. Në vitin 2010, OJQ-ja Qendra Labyrinth në Prishtinë ka realizuar 195 sesione të testimit dhe konsultimit vullnetar dhe ka distribuuar rreth 5000 prezervativë dhe 5000 materiale informative. Kjo iniciativë ishte përkrahur dhe realizuar me asistencën e organizatës 'Partneriteti në shëndetësi'.

Nga tetori i 2009-së, kur ishte hapur vendi i parë për shpërndarjen e gjilpërave dhe shiringave e deri në fund të 2010-së, klientëve i janë shpërndarë 45 063 gjilpëra dhe shiringa, 51 745 prezervativë dhe 9 316 flajera/broshura.

Tregu i drogës dhe krimet e lidhura me drogën

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve është një departament që operon brenda strukturës së Policisë së Kosovës (shtylla e hetimeve), d.m.th. Ministria e Punëve të Brendshme. Departamenti i lartcekur përfaqëson trupin shtetëror i cili është i ngarkuar për të mbledhur dhe analizuar të dhënat dhe informatat, dhe të ofrojë statistika shtetërore në lidhje me dënimet e shqiptuara për droga dhe trafikimin e tyre. Në këtë kontekst, Policia e Kosovës, policia kufitare dhe doganat, ngarkohen me implementimin e ligjit mbi drogat dhe të njëjtat janë të obliguara që në raste të arrestimit apo konfiskimit, të gjitha informatat t'i përcjellin tek seksioni anti-drogë i lartpërmendur. Çdo vit, një raport vjetor publikohet në të dyja gjuhët, anglisht dhe shqip, nga 'Seksioni Qendror për Hetim të Narkotikëve' (SCHN) i cili është nën-departament i 'Drejtorisë për Krimin e Organizuar' (DOC) në Policinë e Kosovës. Qëllimi kryesor i SCHN është hetimi dhe zbulimi i krimeve që lidhen me trafikimin e drogës, si dhe luftimi i të gjitha llojeve të krimin të organizuar përfshirë drogat që operojnë në Kosovë. Të dhënat në lidhje me arrestimet dhe konfiskimin e drogave dërgohen nga Seksioni Regjional i Hetimit të Narkotikëve (SRHN) që gjendet në gjashtë qytetet më të mëdha të Kosovës (Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj).

Raporti në fjalë është i ndarë në dy kapituj kryesorë: njëra pjesë i kushtohet arrestimeve dhe tjetra konfiskimeve. Për shembull, sipas këtij raporti, më 2008 janë përmendur 203 raste të lidhura me drogat. Këto raste lidhen me posedimin e substancave narkotike, trafikimin dhe kultivimin e tyre (EMCDDA, 2010).

Kosova ka qenë pjesë e rrugëve kryesore të trafikimit të drogave nga Lindja (tek vendet fqinje dhe drejt Perëndimit) për vite të tëra, dhe kjo ka shkaktuar rritje në numrin e përdoruesve të drogës, duke e rënduar kështu gjendjen me të cilën përballet Kosova veçanërisht pas vitit 1999.

Ngjarjet zinxhimore të cilat ndodhën në Ballkanin Perëndimor, si shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë dhe luftërat e zhvilluara në këtë territor duke përfshirë edhe luftën në Kosovë, ku janë vërejtur ndryshime, çuan tek një komponentë tjetër e problemit të drogave në Kosovë i cili nuk ishte prezent

në të kaluarën, e që është, tentimi gjithnjë në rritje për prodhimin e narkotikëve, veçanërisht të atyre që mund të kultivohen si produkte në fermë, siç është shembulli i kanabis sativa.

Kanabisi

Kanabisi është e vetmja bimë narkotike që kultivohet në Kosovë dhe që kryesisht përdoret brenda vendit. Sipas Policisë së Kosovës, në periudhat 2007–10, kultivimi i kanabisit është përhapur në shumicën e territorit të vendit.

Tabela 4: Konfiskimi i kanabisit

Përshkrimi i aktiviteteve	2007	2008	2009	2010
Konfiskimi i plantacioneve me kanabis	35	23	35	42
Numri i konfiskuar i bimëve kanabis	21 712	9 249	33 497	9 724
Personat e arrestuar	41	27	42	44

Burimi: Policia e Kosovës, 2010.

Çmimet e produkteve të kanabisit në rrugë janë rritur gjatë vitit 2011. Kështu çmimi për 5 gram marijuanë sillet nga 4 Euro deri në 8 Euro. Përqindja e THC në kanabisin që shitet në rrugë është rreth 3 %.

Marijuana kalon transit përmes Kosovës për në vendet tjera, megjithatë një pjesë e vogël mbetet për tregun e brendshëm. Rrugët kryesore transite për marijuanë janë:

- Shqipëri–Kosovë–Serbi ose Mal i Zi – Shtetet anëtare të BE-së;

- Shqipëri–ish Republika Jugosllave e Maqedonisë–Kosovë–Serbi–Shtetet anëtare të BE-së.

Heroina

Kosova ende konsiderohet vend transit i trafikimit të heroinës. Edhe pse numri i konfiskimeve dhe arrestimeve është rritur nga viti në vit, trafikimi i heroinës mbetet një nga sfidat kryesore për Policinë e Kosovës.

Tabela 5: Konfiskimi i heroinës

Përshkrimi i aktiviteteve	2007	2008	2009	2010
Numri i konfiskimeve	72	66	77	84
Sasia e konfiskuar, në kg	47	44	36	55
Personat e arrestuar	110	98	71	112

Burimi: Policia e Kosovës, 2010.

Sasi në rritje e heroinës së kontrabanduar mbes në Kosovë për përdorim të brendshëm. Viti 2007 shënoi rritje të lehtë në çmimin e heroinës në rrugë (nga 21 Euro në 25 Euro për 1 gram), por më 2008 çmimi mbeti i njëjtë, pa ngritje. Niveli i pastërtisë së heroinës në rrugë është rreth 1 %.

Rrugët transitore kryesore të heroinës që kalojnë përmes Kosovës janë:

Afganistan–Iran–Turqi–Bullgari–ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ose Serbia–Kosovë.

Afganistan–Iran–Turqi–Bullgari–ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ose Shqipëri–Kosovë–Serbi–Shtetet anëtare të BE-së.

Afganistan–Iran–Turqi–Greqi–Shqipëri–Kosovë–Mal i Zi–Shtetet anëtare të BE-së.

Kokaina

Duket se kokaina në Kosovë arrin përmes dërgesave postare apo me anë të korierëve nga Serbia dhe/ose vendet e Amerikës Latine, të cilat janë tradicionalisht të njohura për prodhimin e kokainës. Fillimisht ajo dërgohet në Itali apo Greqi dhe atë zakonisht në sasi të vogla.

Çmimi për 1 gram kokainë sillet nga 45 Euro deri 65 Euro në vitin 2007 dhe nga 50 Euro deri 70 Euro në vitin 2008.

Kosova nuk përdoret si rrugë transite për kokainën, megjithatë kontrabandohet në Kosovë në sasi të vogla për përdorim lokal, për çka është vërejtur se ka tendencë për rritje. Rrugët e trafikimit janë:

Tabela 6: Konfiskimi i kokainës

Përshkrimi i aktiviteteve	2007	2008	2009	2010
Numri i konfiskimeve	3	4	3	2
Sasia e konfiskuar, në kg	2	2	1.5	0.5
Personat e arrestuar	6	7	4	2

Burimi: Policia e Kosovës, 2010.

Greqi–Shqipëri–Kosovë, Mal i Zi–Kosovë, Bullgari ose Rumani–Serbi–Kosovë dhe Greqi–ish Republika Jugosllave e Maqedonisë–Kosovë.

Drogat sintetike nuk konsiderohen si problem për tregun e drogës në Kosovë kur bëhet fjalë për furnizimin apo kërkesën.

Rrugët e drogave sintetike:

Shtetet anëtare të BE-së -Serbi–Kosovë, Serbi–Kosovë–Shqipëri.

Ligjet kombëtare të drogës

Si një shtet i ri Kosova është munduar mjaft të përfshijë normat ndërkombëtare në ligjet e saja kundër drogave (të tri konventat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me drogat).

Më 2008, Parlamenti i Kosovës aprovoi Ligjin mbi Barnat Narkotike, Substancat Psikotropike dhe Prekursorëve. (Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 02/L-128.2008)

Përdorimi, posedimi, prodhimi dhe trafikimi i drogave të ndaluara konsiderohen si shkelje e Kodit Penal të Kosovës. Këto vepra dënohen bazuar në nenet 229, 230, 231 dhe 274 të Kodit Penal të Kosovës.

Çdo person që kapet nga policia për posedim, përdorim, prodhim dhe trafikim të drogave, konsiderohet i dyshuar apo kundërvajtës në lidhje me drogën. Shkelësit e tillë regjistrohen në bazën e të dhënave të Policisë së Kosovës (Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës — SIPK), që tregon numrin e kundërvajtësve për veprat përkatëse.

Eksporti dhe importi i paautorizuar i substancave që janë shpallur të rrezikshme, substancave narkotike apo

psikotropike, dënohet me gjobë dhe burgim për një afat prej 3 deri në 10 vite, sipas nenit 229.

Kultivimi, prodhimi, posedimi, nxjerrja apo përgatitja e substancave që janë shpallur të rrezikshme, narkotike apo psikotropike, për qëllime të shitjes apo shpërndarjes, dënohet me gjobë dhe burgim me afat nga 1 deri në 10 vite. Konsumimi i jashtëligjshëm i narkotikëve, substancave psikotropike apo të ngjashme dhe mundësimi i furnizimit dhe përdorimit për qëllime personale, në kundërshtim me ligjin, ndëshkohet me burgim për një afat nga gjashtë muaj deri në 5 vite, sipas nenit 231.

Ndëshkimi për krim të organizuar përfshinë dënimin në shumë deri në 500 000 Euro dhe burgim me afat nga 7 deri në 20 vite, sipas nenit 274.

Kodi Penal i Kosovës gjithashtu përcakton llojet e hetimeve speciale që mund të merren dhe prokurorisë i lejohej të përdorë mjete të ndryshme investigative, duke filluar nga masat sekrete që ndihmojnë në zbulimin e krimeve të lidhura me trafikimin e drogës.

Strategjia kombëtare mbi drogën

Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr 10/44, i datës 11 qershor 2008, ia besoi Ministrisë së Punëve të Brendshme me mandatin për të përpiluar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit të Drogës në Republikën e Kosovës.

Ministria e Punëve të Brendshme krijoi një Grup Punues dhe nën-grupe punuese për të përpiluar një strategji kundër drogës. Grupi dhe nën-grupet punuese përbëheshin nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm. Këto grupe përfshinin përfaqësues nga Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë për

Sundimin e Ligjit (EULEX), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe organe të tjera evropiane. Mbështetja teknike u sigurua nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Strategjia Shtetërore Anti-Drogë dhe Plani i Aksionit të Kosovës 2009–12 u miratua në qershor 2009 dhe është një dokument i përgjithshëm që mbulon uljen e kërkesës dhe furnizimit me drogë. Strategjia Shtetërore Anti-Drogë dhe Plani i Aksionit i Kosovës 2009–12 është përpiluar në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet publike të përfshira në luftën kundër drogës, përfshirë OJQ-të, në konsultim me ekspertë që punojnë për organizata ndërkombëtare në Kosovë. Akterët kryesorë janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Doganat, Ministria e Arsimit, institucionet e tjera qeveritare dhe organizata të shoqërisë civile.

Studimi në lidhje me drogat

Studimi shkencor është pjesë përbërëse e Strategjisë mbi Drogën dhe Planin e Veprimit kundër trafikimit të drogës në Republikën e Kosovës, së bashku me zhvillimin e një sistemi informativ dhe trajnimi mbi hulumtimin në lidhje me problemet e drogave, megjithëse nuk tregohet hollësisht. Besohet se do të përfshihen segmente të ndryshme institucionale të aftësuara për drejtimin e projekteve hulumtuese mbi drogat. Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik, bashkë me departamentet e tij, mund të luaj rol kyç në programet kombëtare shkencor-hulumtuese në fushën e shëndetit publik, si (a) hulumtimi epidemiologjik lidhur me drogat në popullatën e përgjithshme dhe në grupe të caktuara të saj; (b) zhvillimi i rekomandimeve përkatëse; (c) mbledhja dhe analiza e informatave mbi drogat, si institucion i vetëm, ose në bashkëpunim me institucione të tjera, si dhe pjesëmarrja në zhvillimin e sistemit informativ mbi drogat dhe gjitha të dhënat në lidhje me drogën, nga hulumtimi i vazhduar i institucioneve/agjencive/aktorëve përkatës; (d) vlerësimi i efikasitetit të programeve parandaluese dhe masat në nivel shtetëror, dhe (e) shpërndarja e hulumtimit, rezultateve dhe informatave në lidhje me drogat.

Mekanizmi bashkërendues në fushën e drogave

Zyra e Kryeministrit të Kosovës në vitin 2004 iniciroi themelimin e Komisionit Kosovar për Intervenime në Rastet e Drogave. Ky komision nuk ishte në gjendje të funksionojë dhe të jap rezultatet e pritshme në luftën kundër drogave.

Mekanizmi institucional nënkupton rolin dhe koordinimin e aktivitetëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së

Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Ambientit dhe Planit Hapësinor dhe institucioneve të tjera të Kosovës që janë përgjegjëse dhe luajnë rol në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të drogave dhe keqpërdorimin e prekurësorëve.

Ky mekanizëm udhëhiqet nga Koordinatori Shtetëror (zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme), i cili e ka pranuar detyrën në vitin 2009. Mandati i Koordinatorit Shtetëror është të bashkërendoj, monitoroj dhe raportoj mbi implementimin e politikave dhe aksioneve dhe aktivitetëve në lidhje me drogat.

Mekanizmi gjithashtu përfshinë Sekretariatit, i cili është një trup i ri i ngarkuar me mbledhjen e të dhëna dhe informatave nga institucionet tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të informative dhe të dhënave të tilla, si dhe në përgatitjen e raporteve analitike për Koordinatorin Shtetëror. Sekretariati është i vendosur në Sektorin e Politikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe aty ndodhet një person përgjegjës për përpilimin e raporteve tre-mujore mbi implementimin e Planit të Veprimit.

Referencat

- Brisson, A., Arenliu, A., Shporta, E., Blakaj, S., Cintron, R., Agani, F., Ēeine, S. (2004), *Substance abuse in post-war Kosovo; rates of use, prevention and treatment*.
- Brisson, A., Arenliu, A., Platais, I. (2009), *Rapid assessment and response report with youth, injecting drug users and prisoners*. ĒHO, UNICEF, UNFPA.
- Family Health International (2006), *Bio-behavioral Survey (BBS) with high-risk populations in Kosovo*.
- EMCDDA (2010), 'Needs Assessment Mission Report Kosovo (under UNSCR 1244/99)', July 2010.
- 'Mapping of drug treatment provision in Pristina, gaps in service provisions un-met needs, assessment of workforce development priorities and recommendation for action, Mission Report', SOFRECO, 12–20 December 2006.
- National Anti-Drug Strategy and Action Plan for the period 2009–2012. Available online: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia_16_06_09_finale_kombetare_ENG.pdf
- Safet Blakaj, Lee-Nah Hsu (2008), *Partnerships in health: exploratory analysis of knowledge, attitude and behavior of*

prisoners regarding HIV, hepatitis B and hepatitis C, NGO 'Labyrinth', Pristina. Mund të gjendet në ueb adresën si më poshtë:

<http://www.balkans-fight-hiv.org/documents/Exploratory%20analysis%20in%20prisons.pdf>

Zyra e Statistikave të Kosovës (2010), Seria (Botimi) 1: Statistika e përgjithshme. Kosova sipas të dhënave 2009.

United States Department of State (2010), International Narcotics Control Strategy Report (INCSR 2010 Volume 1).

Mund të gjendet në ueb adresën si më poshtë:

<http://www.state.gov/documents/organization/120054.pdf>



Sadržaj (SR)

Uvod	23
Socijalni demografski pregled	24
Korišćenje droga među opštom populacijom i mladim ljudima	25
Prevenција	25
Problemi korišćenja droga	26
Potrebe za lečenje	26
Infektivne bolesti kao posledica korišćenja droga	28
